

Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale

1. Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, më poshtë QKVT, është institucion i specializuar në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
2. QKVT-ja ushtron veprimtarinë e saj në administrimin, studimin, kërkimin, evidentimin, ruajtjen, mbrojtjen, popullarizimin dhe promovimin e pasurive kulturore jomateriale dhe të diversitetit kulturor në nivel kombëtar, në bashkëpunimin me subjekte publike e private.
3. Në përmbushje të funksioneve të saj, QKVT-ja bashkëpunon me specialistët e trashëgimisë kulturore jomateriale pranë drejtorive rajonale të trashëgimisë kulturore, si dhe me institucionet kulturore-artistike qendrore e vendore, shoqatat kulturore e individë të fushës së trashëgimisë jomateriale.
4. QKVT-ja është organizatore e festivaleve folklorike tipologjike kombëtare, FFTK-ve, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Organizimi i FFTK-ve bazohet në Rregulloren e Festivaleve Folklorike Tipologjike Kombëtare, e cila miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
5. QKVT-ja, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucione të tjera shtetërore e private organizon Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës, bazuar në rregulloren e tij, i cili miratohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Shpallja e organizimit të tij bëhet me urdhër të ministrit, një vit përpara zhvillimit të tij.
6. QKVT-ja ka kompetencë:
  - a) të asistojë ministrinë në ushtrimin e kompetencave të saj për zbatimin e politikave

qeveritare në fushën e ruajtjes, mbrojtjes, promovimit dhe menaxhimit të trashëgimisë  
kulturore jomateriale;

b) të kërkojë, verifikojë dhe studiojë vlerat e trashëgimisë kulturore jomateriale;

c) të krijojë dhe përditësojë Regjistrin Kombëtar të Bartësve të Folklorit, Regjistrin e  
Vlerave të Trashëgimisë Jomateriale, Listën e Artizanëve, të cilët trashëgojnë dijetë të  
ndryshme, Regjistrin e Kryeveprave të Trashëgimisë Jomateriale dhe Listën e Trashëgimisë

Kulturore Jomateriale në Rrezik;

ç) të krijojë dhe mirëmbajë një hartë interaktive të trashëgimisë kulturore jomateriale në  
territorin e Republikës së Shqipërisë;

d) të lëshojë dokumente, kopje të vërtetuara të tyre dhe kopje digjitale të arkivit, sipas  
tarifave të përcaktuara me udhëzim;

dh) të monitorojë në terren të gjitha veprimtaritë e trashëgimisë jomateriale, që zhvillohen  
në rang vendi;

e) të përgatisë raporte apo informacione për trashëgiminë jomateriale, të kërkuara nga  
organizmat ndërkombëtarë, dhe t'i paraqesë ato në KKTKJ;

ë) të kryejë çdo funksion tjetër të parashikuara me ligj.

7. QKVT-ja funksionon si sekretariat teknik i Këshillit Kombëtar të Pasurive Kulturore  
Jomateriale.

8. QKVT-ja funksionon në bazë të përcaktimeve të këtij ligji, si dhe statutit të miratuar  
me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.